

Ftesë

Qendra Shqiptare për Konkurrueshmëri dhe Tregti Ndërkombëtare (ACIT), me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur (OSFA), ka kënaqësinë t'ju ftojë në aktivitetin publik:

“Integrimi ekonomik dhe tregtar midis Shqipërisë dhe Kosovës: Pengesat, sfidat dhe potencialet”

E Enjte, 7 Nëntor, 2019

Ora: 11.00 - 12:30

Vendi: Salla Teuta, Hotel Tirana

Qendra Shqiptare për Konkurrueshmërinë dhe Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT), me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri (OSFA), ka ndërmarrë një studim për të analizuar procesin e integritimit ekonomik dhe tregtar të Shqipërisë dhe Kosovës. Objektivi i këtij projekti është informimi dhe ndërgjegjësimi mbi rëndësinë dhe potencialet e zhvillimit të hapësirës së përbashkët ekonomike midis dy vendeve. Për këtë qëllim, ekspertët e angazhuar kanë realizuar monitorimin dhe analizën e zbatimit të marrëveshjeve dy palëshe, identifikimin dhe listimin e barrierave të ndryshme, si dhe analizën ekonometrike të potencialeve të pashfrytëzuara midis dy ekonomive.

Në kuadër të prezantimit dhe diskutimit të gjetjeve paraprake nga ky studim, si dhe të marrjes së mendimeve të aktorëve të rëndësishëm institucionalë dhe të botës së biznesit, ju ftojmë në këtë aktivitet, sipas axhendës më poshtë.

Ju lutemi të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në adresën e-mail: info@acit.al

AXHENDA E AKTIVITETIT

10:45 - 11:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

11:00 - 11:15 Hapja e aktivitetit dhe fjalët përshëndetëse

Moderator: Z. Gentian Elezi, ACIT

Znj. Belinda Ikonomi, Zv.Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Z. Andi Dobrushki, Drejtor i Fondacionit për Shoqërinë e Hapur

11:15-11:30 Gjetjet dhe rekomandimet paraprake mbi tregtinë Shqipëri-Kosovë

Z. Selami Xhepa, ekspert i asociuar, ACIT

Znj. Mimoza Agolli, eksperte e asociuar, ACIT

11:30 - 12:15 Ndërhyrje dhe diskutim i hapur me përfaqësuesit e biznesit

12:15 - 12:30 Pyetje dhe konkluzionet e aktivitetit